REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD FERIZAJ I UROSEVAC

P.nr.871/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ–DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni penal, me gjyqtarin si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin individual Mustaf Tahiri si dhe me bashkëpunëtoren profesionale Albina Varoshi në çështjen penale kundër të pandehurit [redacted] për shkak të veprës penale mashtrimi sipas neni 335 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1381-4/15 të dt. 22.09.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit Avdullah Abedini, të pandehurit [redacted] si dhe te dëmtuarës [redacted] me datë 01.06.2017 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me dt. 06.06.2017 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari [redacted] i lindur me dt. [redacted], nga i ati [redacted] e ëma [redacted] e gjinisë [redacted] i pa martuar, me vendbanim ne rrugën e "[redacted]" nr. [redacted] Ferizaj, (përball postës kryesore), i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 15.07.2015 ne qendrën tregtare " [redacted], me qëllim që vetës të i sjelle përfitim pasuror te kundërligjshëm, me paraqitjen e fakteve te rreme i pandehuri nga e dëmtuara [redacted] ka bërë këmbimin e arit si zingjir qafe, një hallke dore dhe një pale vath me vlerë të përgjithshme rreth 500€, i pandehuri të dëmtuarës i ka prezantuar dy zingjir dhe një pllakë të cilat nuk kane qenë ari por bizhuteri në vlerë prej 5 €.

Me këtë kreu veprën penale mashtrimi nga neni 335 par.1 te KPK-së.

Andaj, në bazë të dispozitës ligjore të sipër theksuar, si dhe dispozitave ligjore nga neni 4,5,8,21,41,43,45,46,49,51,53,73,74, të KPK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurin e

GJYKON

DENIM ME GJOBË në lartësi prej 500 (pesëqind) euro, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse dënimi i shqiptuar nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara në nen. 46 të KPK-së, do të ekzekutohet në atë mënyrë që për çdo 20 (njëzet) € i pandehuri do të vuaj një ditë burgu.

Si dhe **DËNIM BURGIMI** në kohëzgjatje prej 4 /katër/ muaj, dhe në të njejtën kohë urdhëron që dënimi me burgim të mos ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej 1 /një/ viti pasi ky aktgjykim të merre formën e prerë nuk do të kryej vepër tjetër penale.

E dëmtuara [redacted] rr." [redacted]", Ferizaj afër "[redacted]" kati i [redacted] hyrja [redacted] për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

Obligohet i akuzuari që të paguajnë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m i

PTH në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1381-4/15 e dt.22.09.2016 ka ngarkuar të akuzuarin [redacted] për veprën penale mashtrimi nga neni 335 par. 1 të KPRK-së, mbeti në tërësi pranë aktit akuzues, duke kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet sanksion penal i paparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për te cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari individual.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 01.06. 2016 në të cilën shqyrtim gjyqësor: *i akuzuari është deklaruar fajtor*

rrethanave veçanërisht rënduese Gjykata vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale për të pandehurin dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, mbi baze të këtyre rrethanave i shqiptoj dënimin me kusht si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Në bazë të nenit 463 par. 2 të KPPK-së, gjykata të dëmtuarën, [redacted] rr." [redacted]" [redacted] (afër" [redacted] "kati i [redacted] për realizimin e kërkesës pasurore juridike e ka udhëzuar ne kontest civil, për shkak se të dhënat në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë apo të pjesshëm të kërkesës pasurore juridike.

Në bazë të nenit 450 dhe 451 të KPPK-së, gjykata të akuzuarin i obligoi që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 euro, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL
P.nr.871/16 dt.06.06.2017

Bashkëpunëtore profesionale,
Albina Varoshi

Varoshi

Asistuesi Individual,
Mustafë Tahiri

REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVA · GJYKATA THEMELORE FERIZAJ · SUDI PRANONSO SUD URDJEVAC

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit. Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet Gjykatës Themelore Ferizaj.